

Përmbledhje e Aktgjykimit

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës (KSC-BC-2020-04)

1. Trupi Gjykses I do të shqiptojë sot Aktgjykimin në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës*. Trupi Gjykses përbëhet nga gjykatësit Roland Dekers, Zhilber Biti, Vladimir Mikula, gjykatës rezervë dhe unë Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse. Ky Aktgjykim shqiptohet publikisht, në emër të popullit të Kosovës dhe në prani të z. Shala, të akuzuarit.
2. Kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit Pjetër Shala gjatë periudhës afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999.
3. Aktgjykimi i sotëm është aktgjykimi i dytë për krime lufte i kësaj gjykate. Ai i kontribuon vendosjes së drejtësisë për viktimat dhe vënies para përgjegjësisë të kryesve për shkelje të rënda të së drejtës humanitare dhe penale ndërkombëtare brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.
4. Në vijim, unë do të lexoj një përmbledhje të konstatimeve kryesore të bëra nga Trupi Gjykses. Kjo përmbledhje nuk është pjesë e Aktgjykimit, i cili është i vetmi dokument autoritativ që përmban konstatimet dhe verdiktin e Trupit Gjykses. Aktgjykimi do të njoftohet në fund të seancës së sotme. Përmbledhja do të jetë gjithashtu e disponueshme në faqen e Dhomave të Specializuara në Internet.
5. Kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me krime lufte të cilat u kryen në fabrikën e dikurshme të metalit në Kukës, Shqipëri, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999. Gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat, fabrika e metalit në Kukës – të cilës unë do t'i referohem si FMK – shërbeu si shtab i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe u përdor për qëllime të ndryshme, ndër to rekrutimi, mobilizimi dhe logjistika. Trupi Gjykses ka marrë dëshmi të besueshme, përputhëse dhe që konfirmojnë njëra-

tjetrën gjatë zhvillimit të këtij gjykimi, nga një numër dëshmitarësh se FMK-ja u përdor nga disa anëtarë të UÇK-së edhe për të mbajtur të ndaluar, marrë në pyetje dhe keqtrajtuar persona, të cilët mendohej se bashkëpunonin, kishin lidhje ose simpatizonin autoritetet serbe, ose që konsideroheshin se nuk i përkrahnin mjaftueshëm përpjekjet e UÇK-së. Numri i gjithsejtë i të ndaluarve në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat nuk dihet, por vlerësohet të ketë qenë rreth 40 persona, përfshirë tri të ndaluara femra. Trupi Gjykses arriti të identifikonte tetëmbëdhjetë (18) persona, të cilët u mbajtën të ndaluar në FMK gjatë periudhës relevante.

6. Trupi Gjykses e zhvilloi këtë gjykim në kontekstin e atmosferës së vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve. Kjo atmosferë ka pasur një ndikim të dukshëm, ndonëse në shkallë të ndryshme, në dëshmitë e dhëna nga disa prej dëshmitarëve të cilët dolën para Trupit Gjykses. Megjithatë, vlen të theksohet se gjatë këtij gjykimi, Trupi Gjykses ka dëgjuar disa dëshmi të dorës së parë nga dëshmitarët për ngjarjet traumatike të përjetuara prej tyre gjatë ndalimit të tyre në FMK dhe ndikimin e vazhdueshëm fizik dhe psikologjik që këto ngjarje kanë pasur në jetën e tyre dhe në jetën e familjeve të tyre. Viktimat ishin kryesisht shqiptarë të Kosovës, të cilët kanë pësuar vuajtje nga shqiptarë të tjerë të Kosovës. Dëshmitë e tyre ishin të gjalla, të hollësishme dhe bindëse. Disa prej këtyre dëshmitarëve janë gjithashtu viktima pjesëmarrëse në këtë proces.

7. Dëshmitarët folën edhe për përpjekjet e tyre për të gjetur drejtësi gjatë njëzet e pesë (25) viteve të fundit. Po citoj një prej tyre: “ [...] Se me pasë ligj e shtet [në Kosovë], [...] ish kry atje, e kishin kry [...]. Po kush me e kry? Se s’ka guxu kërrkush me i marrë lëndë napër dorë” – fundi i citimit.

8. Në vijim, unë do të rikujtoj shkurtimisht akuzat dhe më pas do të përmbledh konstatimet e Trupit Gjykses në Aktgjykim në lidhje me të akuzuarin, z. Shala.

AKUZAT

9. Do të filloj me akuzat.
10. Z. Shala është shtetas belg, i lindur më 17 shtator 1963, në Prizren, Kosovë. Ai njihet edhe me pseudonimin "Ujku".
11. ZPS-ja ngriti katër (4) akuza për krime lufte kundër z. **Shala** sipas formave të ndryshme të përgjegjësisë penale, në bazë të neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Krimet e luftës për të cilët janë ngritur akuza janë ndalimi arbitrar, trajtimi mizor, torturimi i së paku nëntë personave dhe vrasja e paligjshme e një personi, të kryera afërsisht midis 17 majit dhe 5 qershorit 1999 në FMK.
12. Z. Shala u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat.

RRETHANAT KONTEKSTUALE DHE POZITA E Z. SHALA.

13. Tani po vijoj me rrethanat kontekstuale dhe pozitën e z. Shala.
14. Z. Shala ishte anëtar i UÇK-së para dhe gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Ai fillimisht iu bashkua UÇK-së në mars 1998 dhe shpejt pas kësaj u emërua si komandant ose oficer në policinë ushtarake të UÇK-së në Jabllanicë. Ai qëndroi në UÇK deri dikur në verën e vitit 1998, kur u largua nga Kosova për në Belgjikë.
15. Z. Shala iu ribashkua UÇK-së në Shqipëri, në Kukës, në fund të marsit 1999 dhe qëndroi në UÇK deri dikur në qershor/korrik 1999, pas përfundimit të konfliktit të armatosur. Gjatë të gjithë periudhës që lidhet me akuzat, z. Shala ishte në disa raste fizikisht i pranishëm në FMK. Ai shkonte e vinte në FMK shumë shpesh dhe pa kufizime. Ndonëse nuk kishte rang apo pozitë zyrtare të përcaktuar, ai gëzonte njëfarë autonomie.

KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES NË LIDHJE ME KRIMET PËR TË CILAT JANË NGRITUR
AKUZAT

16. Tani do të trajtoj konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.

17. *Ndalimi arbitrar.* Do të filloj me Pikën 1, ndalim arbitrar. Bazuar në provat, Trupi Gjykses ka konstatuar se të paktën tetëmbëdhjetë (18) personave të identifikuar iu hoq liria nga anëtarë të UÇK-së në FMK, afërsisht midis 17 majit dhe 5 qershorit 1999.

18. Provat tregojnë se këta persona u arrestuan dhe u mbajtën të ndaluar me pretendime të mjegullta se ishin “tradhtarë” ose “bashkëpunëtorë” të autoriteteve serbe, simpatizonin Serbinë, ose nuk mbështesnin mjaftueshëm përpjekjet e UÇK-së, financiarisht, ushtarakisht apo politikisht. Rrethanat e arrestimit të një numri prej tyre tregojnë se paraprakisht ishin bërë hetime lidhur me vendndodhjen e tyre: të ndaluarit u arrestuan në vendin ku banonin, në rrugë, pas mbërritjes në Shqipëri nga jashtë, në kampet e refugjatëve apo kudo ku kishin gjetur strehim pasi ishin dëbuar nga Kosova. Të ndaluarit u çuan drejtpërdrejt në FMK me vetura ose furgonë, ose u çuan fillimisht në vende të tjera ndalimi (të përkohshme) në veri të Shqipërisë dhe më pas u transferuan në FMK. Për kontrollimet, arrestimet dhe transferimet e të ndaluarve në FMK duket të ketë ekzistuar organizim, logjistikë dhe personel në një shkallë të qenësishme.

19. Anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së u përfshinë qartazi në arrestimin dhe transferimin e të ndaluarve në FMK, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së. Z. Shala u përfshi drejtpërdrejt në transferimin e një prej të ndaluarve në FMK.

20. Të ndaluarit u sollën në FMK dhe u liruan më pas në vazhdimësi. Disa u mbajtën në FMK për disa ditë, disa të tjerë deri në një muaj.

21. Në asnjë moment gjatë ndalimit të tyre personave të ndaluar nuk iu dhanë garancitë bazë që u takonin gjatë kohës së ndalimit, në përputhje me të drejtën humanitare ndërkombëtare. Konkretisht, ata nuk u informuan si duhet për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxorën pa vonesë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër

kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre. Përkundrazi, gjatë gjithë periudhës së ndalimit, siç do të shtjelloj shkurtimisht, një numër të ndaluarish u keqtrajtuuan rëndë nga anëtarë të UÇK-së, ndër ta dhe z. Shala. Disa të ndaluar u detyruan të jepnin deklarata pranuese dhe njëri prej tyre u vra.

22. *Trajtim mizor dhe torturë.* Tani do të trajtoj Pikat 2 dhe 3, që janë përkatësisht trajtimi mizor dhe tortura. Bazuar në provat, Trupi Gjykses gjithashtu ka konstatuar se të paktën tetëmbëdhjetë (18) të ndaluar të identifikuar, të cilëve iu hoq liria në FMK, u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat. Të ndaluarit u mbajtën në dhoma të vogla pa shtretër, ku në një dhomë ishin deri në trembëdhjetë (13) të ndaluar. Anëtarë të UÇK-së nuk i linin të flinin, i ngacmonin ose hynin në dhomën e tyre gjatë natës për t'i keqtrajtuar. Atyre nuk u jepej ushqim dhe ujë i mjaftueshëm ose i përshtatshëm. Një dëshmitar kujtoi se nganjëherë dy të ndaluar ndanin një vezë të zierë mes tyre. Herë të tjera atyre nuk iu dha aspak ushqim. Të ndaluarit nuk lejoheshin të laheshin ose të ndërronin teshat. Ata duhej të kërkonin leje për të përdorur banjat, të cilat ishin në gjendje të keqe. Të ndaluarit shkonin të shoqëruar në banjë e ndonjëherë pësonin ngacmime rrugës. Dëshmitarët deklaruan se kushtet e ndalimit, citoj: “kanë qenë në atë mënyrë që as kafshët apo bagëtitë nuk do të qëndronin aty” – fundi i citimit. Të ndaluarve nuk iu dha ndihmë mjekësore e mjaftueshme ose iu refuzua ndihma mjekësore. Gjithashtu, të ndaluarit nuk lejoheshin të flisnin me njëri-tjetrin, gjë që vetëm ua përforcoi frikën dhe ankthin.

23. Të ndaluarit gjithashtu u morën në pyetje ashpërsisht, më së shpeshti gjatë natës. Të ndaluarit u pyetën për punën e tyre, vendndodhjen e tyre para dhe gjatë luftës, marrëdhëniet e tyre me serbët dhe njohuritë e tyre për “bashkëpunëtorët” e serbëve. Vetë ata gjithashtu u akuzuan në mënyrë të mjegullt si “bashkëpunëtorë të serbëve”, “spiunë”, “tradhtarë”, “vrasës”, ose “përdhunues”. Disa u detyruan të jepnin deklarata me shkrim dhe deklarata pranuese. Marrjet në pyetje u kryen nga anëtarë të

ndryshëm të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi. Z. Shala ishte i pranishëm edhe kur anëtarë të tjerë të UÇK-së merrnin në pyetje të ndaluarit.

24. Krahas kushteve çnjerëzore dhe poshtëruese të ndalimit dhe marrjeve në pyetje në mënyrë të ashpër, Trupi Gjykes ka konstatuar mbi bazën e provave se të ndaluarit u keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht përditë nga disa anëtarë të UÇK-së. Ata u rrahën gjatë gjithë natës deri në orët e hershme të mëngjesit, u detyruan të godisnin njëri-tjetrin, përfshirë me shuplaka, u detyruan të shtireshin sikur po kryenin marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin dhe u detyruan të bënin punë krahu. Të ndaluarit gjithashtu u detyruan të shikonin dhe dëgjonin keqtrajtimin fizik të personave të tjerë të ndaluar me ta. Ata u ngacmuan dhe u kërcënuan me dhunë ose me vdekje. Si rezultat, ata jetonin në një gjendje frike të vazhdueshme se mund të keqtrajtoheshin ose madje të vriteshin në çdo moment. “Veç minutat i pritshim kur të vdesim”, kujton njëri prej tyre, duke dëshmuar për atmosferën e terrorit dhe pasigurinë që ndjenin.

25. Gjatë marrjeve në pyetje, anëtarë të UÇK-së rrahën disa prej të ndaluarve në një mënyrë veçanërisht brutale dhe i keqtrajtuuan ata në forma të tjera. Anëtarët e UÇK-së i rrahën të ndaluarit me shkopinj gome dhe shkopinj bejsbolli në të gjithë trupin, i shkelmuan, i goditën me grushte, i prenë me thika, i dogjën me cigare dhe u hodhën kripë në plagë. Disa prej të ndaluarve u qëlluan edhe me armë. Keqtrajtimi i la ata të mavijosur, të mbuluar në gjak, të pafuqishëm për të qëndruar në këmbë apo edhe pa ndjenja. Një dëshmitar kujtoi, dhe po e citoj: “S’di sa herë më ka ra të lightë”; “Kanë lëshu ujë; jam kthjellë; më kanë rreh prapë. Tërë natën q’ashtu ka vazhdu” – fundi i citimit.

26. Rrahjet u kryen nga një numër anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi. Anëtarët e UÇK-së i rrihnin me rend të ndaluarit. Një dëshmitar e përshkroi kështu koordinimin mes tyre, dhe citoj: “Do atëherë të vrevshin u dujke me u përgjigj këtijne, ta bëjke pyetjen në ky. Tyj ju përgjigjshe këtijne, thojke

pse s'mu përgjigjesh mu. [...] U kthejshe me folë me këtë, pa mbaru bisedën me këtë, pse spo përgjigjesh mu, të bike tjetri" – fundi i citimit.

27. Keqtrajtimi fizik dhe psikologjik, i shoqëruar me kushtet çnjerëzore të ndalimit, u shkaktuan të ndaluarve lëndime afatgjata, si fizike ashtu dhe mendore si: lëndime në kokë, lëndime nga djegiet, thyerje të gjymtyrëve dhe dhëmbëve, dhimbje të vazhdueshme dhe të forta në të gjithë trupin, ndjenjë turpi, frikë (për shembull, për të shkuar në punë ose për të dalë jashtë i pashoqëruar), ndjenjë pasigurie (në lidhje me veten ose anëtarët e familjes së tyre) dhe çrregullime të stresit pastraumatik që përfshin simptoma si makthe, fanitje të ngjarjeve traumatike dhe kujtime tronditëse të pavullnetshme.

28. *Vrasje e paligjshme*. Së fundi, po trajtoj Pikën 4, vrasje e paligjshme. Trupi Gjykues, bazuar në provat, ka konstatuar se më 4 qershor 1999 ose rreth kësaj date, një prej të ndaluarve (viktima e vrasjes së paligjshme) u keqtrajtua rëndë nga një grup anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala dhe Xhemshit Krasniqi, dhe u qëllua me armë zjarri në këmbë nga ky i fundit. Z. Shala mori pjesë në keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme para dhe madje edhe pasi ai u qëllua me armë zjarri.

29. Keqtrajtimi dhe gjuajtja me armë zjarri i shkaktuan viktimës së vrasjes së paligjshme mavijosje në të gjithë trupin. Ai nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë apo të urinonte, kishte gjakderdhje të madhe nga plagët me armë zjarri në këmbë për shkak të shkatërrimit të plotë të një arterieje. Një mjek këshilloi që ai të dërgohej në spitalin e Kukësit, ndryshe nuk do të mbijetonte. Megjithatë, një prej anëtarëve të UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit në FMK nuk lejoi transferimin e tij dhe deklaroi, po citoj: "s'ja kena bo këtë dajak për me e çu tek mjeku" – fundi i citimit.

30. Viktima e vrasjes së paligjshme – pas një agonie të tmerrshme – vdiq të nesërmen, më 5 qershor 1999 ose rreth kësaj date, ndërkohë që mbahej ende i ndaluar në FMK, si pasojë e plagëve të shkaktuara nga arma e zjarrit, ndërthurur me refuzimin e trajtimit të duhur mjekësor.

31. *Konteksti.* Para se të kaloj te pjesëmarrja e z. Shala në krime, do të them disa fjalë në lidhje me: (i) ekzistencën e konfliktit të armatosur, në kontekstin e të cilit u kryen krimet; dhe (ii) dijeninë e kryesve për këtë konflikt. Trupi Gjykses ka konstatuar se krimet për të cilat janë ngritur akuzat u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe. Z. Shala dhe anëtarët e UÇK-së në FMK ishin në dijeni të rrethanave që vërtetojnë konfliktin e armatosur jondërkombëtar. Ata ishin po kështu në dijeni të statusit të viktimave si persona që nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime, duke qenë se atyre u ishte hequr liria në FMK.

PJESËMARRJA E Z. SHALA NË KRYERJEN E KRIMEVE TË PARAQITURA

32. Tani do t'i kthehem pjesëmarrjes së z. Shala në kryerjen e krimeve të paraqitura në akuza.

33. Trupi Gjykses, në bazë të provave, ka konstatuar se z. Shala mori pjesë – së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së – në transferimin nën rojë të njërit prej të ndaluarve në FMK.

34. Z. Shala gjithashtu mori pjesë në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e disa të ndaluarve dy herë, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi. Z. Shala ishte i pari që goditi disa të ndaluar. Dëshmitarëve u kujtohej konkretisht brutaliteti i tij. Njëri prej të ndaluarve tha se z. Shala e rrahu me shkop bejsbolli dhe shkop gome në të gjithë trupin, përfshirë në kokë. Ndërkohë që e rrihte, z. Shala e akuzoi se ishte "spiun". Z. Shala gjithashtu i urdhëroi të ndaluarit të rrihnin njëri-tjetrin, që zbulon se ai kishte njëfarë pushteti kur bëhej fjalë për keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK. Gjithashtu, z. Shala mori në pyetje një të ndaluar për të marrë pranim prej tij.

35. Në një moment gjatë mbajtjes në ndalim të një dëshmitari, z. Shala i tha një dëshmitar, citoj: "Do të vrasim, do të ekzekutojmë" – fund i citimit.

36. Pjesëmarrja personale e z. Shala në transferimin e një të ndaluarit në FMK dhe pjesëmarrja e tij, në mënyrë të përsëritur, në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve, bashkë me dijeninë e tij se në FMK kishte të ndaluar, tregojnë se ai mori pjesë në heqjen e qëllimshme të lirisë këtyre personave dhe e dinte se atyre nuk iu dha asnjë garanci bazë gjatë gjithë periudhës së ndalimit të tyre. Gjithashtu, z. Shala nuk pati arsye për të besuar se për shkak të sigurisë ndalimi i këtyre personave ishte absolutisht i domosdoshëm. Për shembull, z. Shala ishte në dhomë kur disa të akuzuarve iu bënë akuzime, ndër të cilët viktimës së vrasjes së paligjshme, teksa i rrihnin. Ai madje personalisht u bëri akuzime disa të ndaluarve. Rrjedhimisht, ai ishte plotësisht i vetëdijshëm se këta persona nuk u mbajtën në FMK në bazë të akuzave konkrete dhe se arsyet e sigurisë nuk e bënë ndalimin e tyre absolutisht të domosdoshëm.

37. Pjesëmarrja personale e z. Shala në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e disa të ndaluarve tregon më tej se ai u shkaktoi të ndaluarve qëllimisht dhimbje ose vuajtje të rëndë, për të marrë prej tyre informata ose deklarata pranuese, për t'i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar dhe/ose diskriminuar për arsye politike.

38. Trupi Gjykes ka konstatuar gjithashtu se z. Shala kishte synimin për të vrarë. Kjo demonstron prej një numri faktorësh: (i) mënyrës në të cilën ai rrahu të ndaluarit (si për shembull, duke i goditur në kokë me shkop bejsbolli dhe gome); (ii) faktit që ai një të ndaluarit i tha shprehimisht, dhe citoj: “Do të vrasim, do të ekzekutojmë” – fund i citimit; (iii) faktit që ai ishte i pranishëm kur anëtarë të tjerë të UÇK-së i goditën të ndaluarit me armë dhe madje shtinë kundër tyre, sikurse në rastin e viktimës së vrasjes së paligjshme; (iv) faktit që ai ishte dëshmitar i dhunës së skajshme të shkaktuar ndaj të ndaluarve dhe pa se u rridhte gjak, përfshirë nga koka, nuk ishin në gjendje të ecnin, dhe humbën vetëdijen; dhe (v) z. Shala vazhdoi të merrte pjesë në keqtrajtimin e të ndaluarve, përfshirë të viktimës së vrasjes së paligjshme, edhe pasi viktimat e vrasjes së paligjshme u qëlluan me armë zjarri dhe kishte gjakderdhje të madhe.

39. Tani do të trajtoj konstatimet ligjore të Trupit Gjykses Trupi Gjykses konstaton se është përmbushur secili prej elementet përbërëse të ndalimit arbitrar si krim lufte (Pika 1), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4). Sa i përket trajtimit mizor si krim lufte (Pika 2), Trupi Gjykses vë në dukje se faktet bazë të akuzës së trajtimit mizor janë identike me faktet bazë të akuzës së torturës. Duke pasur parasysh se tortura është akuzë më konkrete, akuza e trajtimit mizor mbulohet tërësisht nga akuza e torturës. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk e ka shqyrtuar këtë akuzë më tej.

40. Në lidhje me formën e pjesëmarrjes së të akuzuarit në këto krime dhe kategorinë e përgjegjësisë penale, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala mban përgjegjësi penale individuale për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme si pjesë e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, në formën bazë të saj.

41. Anëtarët e kësaj ndërmarrjeje kriminale të përbashkët – ku përfshiheshin Xhemshit Krasniqi, anëtarë të tjerë të policisë ushtarake të UÇK-së, Sabit Geci dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së – patën qëllimin e përbashkët që të ndalonin arbitrarisht, merrnin në pyetje, torturonin dhe vrisnin në mënyrë të paligjshme të ndaluarit në FMK, të cilët mendohej se bashkëpunonin, kishin lidhje, ose ishin simpatizantë të autoriteteve serbe ose konsideroheshin se nuk përkrahnin mjaftueshëm përpjekjet e UÇK-së. Nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në transferimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK, z. Shala dha kontribut të qenësishëm në realizimin e këtij qëllimi të përbashkët.

42. Z Shala kishte të njëjtin synim për kryerjen e krimeve të luftës së ndalimit arbitrar, torturës, dhe vrasjes së paligjshme si anëtarët e tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët.

43. Rrjedhimisht, bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton jashtë dyshimit të arsyeshëm se z. Shala është fajtor, sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit, për Pikat 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës së Konfirmuar, për kryerjen e veprave penale në vijim: (i) ndalim arbitrar si krim lufte (Pika 1), kundër së paku tetëmbëdhjetë (18) personave, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 në Fabrikën e Metalit në

Kukës; (ii) torturë si krim lufte (Pika 3), kundër së paku tetëmbëdhjetë (18) personave, afërsisht midis 17 maji 1999 dhe 5 qershorit 1999 në Fabrikën e Metalit në Kukës; dhe (iii) vrasje e paligjshme si krim lufte (Pika 4), kundër një (1) personi më 5 qershor 1999, ose rreth asaj date, në Fabrikën e Metalit në Kukës.

44. Tani do të flas për dënimin. Para shqiptimit të verdiktit dhe të dënimit, do të bëj një përmbledhje të shkurtër të qëllimeve të dënimit dhe të faktorëve të shqyrtuar nga Trupi Gjykes në përcaktimin e dënimit të përshtatshëm për veprat penale për të cilat z. Shala është penalisht përgjegjës.

45. Trupi Gjykes rikujton se ndëshkimi dhe parandalimi janë ndër qëllimet kryesore të dënimit të individëve të shpallur fajtorë për vepra penale.

46. Për më tepër, Trupi Gjykes dëshiron të theksojë rëndësinë e nxjerrjes para drejtësisë të kryesve të krimeve të rënda që janë shqetësim për të gjithë bashkësinë ndërkombëtare, për t'i dhënë fund mosndëshkimit – edhe dekada pas ngjarjeve në fjalë dhe pavarësisht nga ekzistenca prej kohësh e atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.

47. Dënimi duhet gjithashtu të pasqyrojë edhe thirrjen për drejtësi nga persona të cilët - drejtpërdrejt ose tërthorazi – ishin viktimat të veprave penale. Një qëllim tjetër i rëndësishëm i dënimit është njohja e dëmit dhe vuajtjeve që u janë shkaktuar viktimave dhe gjithë shoqërisë.

48. Gjithashtu, qëllimi i dënimit të dhënë nga Trupi Gjykes është që të bëjë më se të qartë se rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare duhet të respektohen në të gjitha rrethanat dhe në të gjitha vendet.

49. Së fundi, Trupi Gjykes gjykon se zbatimi i parimit të barazisë para ligjit është gjithashtu një qëllim tjetër i dënimit në çështjen aktuale.

50. Për t'i dhënë kontekst vlerësimit të Trupit Gjykes, unë do të rikujtoj se çfarë kërkuan palët. Prokurorja e Specializuar kërkoi që z. Shala t'i jepet një dënim i njësuar me 28 vjet burgim, duke qenë se kjo sasi vitesh pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale

të tij. Mbrojtja parashtroi se në rast të një verdikti fajësie, dënimi duhet të jetë i drejtë dhe proporcional e të përcjellë humanizëm. Mbrojtësi i Viktimave nuk kërkoi dënim më vete për secilën prej akuzave, por argumentoi se dënimi do të duhej të ishte “mjaft i konsiderueshëm”.

51. Në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses ka shqyrtuar faktorët në vijim: (i) peshën e krimeve dhe pasojat e tyre; (ii) kontributin personal të personit të shpallur fajtor në këto krime; (iii) rrethanat individuale të personit të dënuar; dhe (iv) ekzistencën e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në lidhje me këta faktorë, nëse ka.

52. Sa i takon peshës së krimeve, Trupi Gjykses gjykoi se ndalimi arbitrar është i rëndë, sepse i bën viktimat të cenueshme ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut; tortura përfaqëson dhunim të dinjitetit, sigurisë, dhe mirëqenies mendore dhe fizike të njeriut; dhe vrasja e paligjshme është vetiu një nga krimet më të rënda, sepse vlera që mbrohet është jeta e njeriut.

53. Në këtë çështje, të paktën tetëmbëdhjetë (18) persona u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi në FMK. Ata u keqtrajtuar rregullisht psikologjikisht dhe fizikisht; dhe jetonin në frikë të vazhdueshme se mund të bëheshin objekt i keqtrajtimit fizik në çdo moment apo edhe të vriteshin. Ata u detyruan të shihnin dhe të dëgjonin keqtrajtimin fizik të të ndaluarve të tjerë dhe i panë ata të mbuluar në gjak dhe me mavijosje, gjymtyrë të ënjtura ose dhëmbë të thyer. Viktima e vrasjes së paligjshme vdiq ndërsa ende mbahej i ndaluar në FMK, si pasojë e plagëve të shkaktuara nga armë zjarri, si dhe në vijim prej refuzimit të trajtimit mjekësor të duhur. Të ndaluarit e tjerë u detyruan ta shihnin atë në agoni të tmerrshme, para se të vdiste.

54. Sa u takon pasojave të krimeve, Trupi Gjykses vëren se, si pasojë e ndalimit arbitrar dhe torturës, viktimat pësuan lëndime afatgjata, si fizike ashtu edhe mendore, sikurse e përmenda më herët. Gjithashtu, disa viktimat humbën aftësinë për të fituar jetesën, për të mbajtur familjet e tyre ose për të rifituar pavarësinë financiare. Trupi

Gjykues po ashtu ka marrë parasysh ndikimin e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme ndaj atyre që ishin dëshmitarë të keqtrajtimit dhe vdekjes së tij dhe pasojat që pati për anëtarët e familjes së tij.

55. Trupi Gjykues gjithashtu mori parasysh dy rrethana rënduese, konkretisht se torturimi u krye me egërsi të veçantë dhe viktimat ishin veçanërisht të cenueshme apo të pambrojtura.

56. Për këto arsye, Trupi Gjykues vlerësoi se pesha e krimeve ishte e rëndë.

57. Sa i përket kontributit personal të z. Shala në këto krime, Trupi Gjykues thekson se z. Shala luajti rol aktiv në grupin e anëtarëve të UÇK-së të cilët mbajtën të ndaluar në mënyrë arbitrare, torturuan dhe vranë në mënyrë të paligjshme të ndaluarit në FMK. Ai kishte njëfarë autonomie dhe pushteti brenda UÇK-së në FMK, megjithëse pa pasur rol komandues. Gjithashtu, Trupi Gjykues rikujton se z. Shala personalisht dhe qëllimisht keqtrajtoi disa të ndaluar në FMK.

58. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues e vlerësoi të lartë shkallën e kontributit personal të z. Shala si dhe synimin e tij në krimet e shqyrtuara.

59. Së fundi, sa u përket rrethanave personale të z. Shala, megjithëse Trupi Gjykues pranon përvojat e vështira të z. Shala që lidhen me konfliktin, ai u jep pak peshë këtyre rrethanave. Trupi Gjykues nuk ka identifikuar asnjë rrethanë tjetër individuale që do të përlligjte uljen e dënimit.

60. Këtu përfundon përmbledhja e konstatimeve të Trupit Gjykues.

Tani do të shqiptoj vendimin.

61. Z. Shala, ju lutem ngrihuni në këmbë.

62. Në emër të popullit të Kosovës, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim dhe të përmbledhura më lart dhe, duke marrë parasysh të gjitha provat dhe argumentet e palëve dhe Mbrotjtësit të Viktimave, Trupi Gjykues, në bazë të neneve 43 dhe 44 të

Ligjit dhe rregullave 158, 159 dhe 163 të Rregullores, ju shpall ju, z. Pjetër Shala, FAJTOR për veprat penale në vijim:

- a) Pika 1, ndalim arbitrar si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit (si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj);
- b) Pika 3, torturë si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit (si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj); dhe
- c) Pika 4, vrasje e paligjshme si krim lufte, në bazë të nenit 14(1)(c)(i) dhe nenit 16(1)(a) të Ligjit (si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj).

Trupi Gjykses ju shpall TË PAFAJSHËM për krimin e luftës të trajtimit mizor në Pikën 2.

Tani do të shqiptoj dënimin.

63. Z. Shala, duke qenë se jeni shpallur fajtor për më shumë se një vepër penale, Trupi Gjykses ka përcaktuar nga një dënim më vete për secilën vepër penale, për të cilën është dhënë verdikt fajësie në bazë të rregullës 163(4) të Rregullores. Së pari do të jap këto dënime më vete, e më pas do të shqiptoj dënimin e njësuar për sjelljen tuaj kriminale në tërësi.

64. Trupi Gjykses ka përcaktuar dënimet në vijim:

- (i) dënim me gjashtë (6) vjet burgim për krimin e luftës së ndalimit arbitrar (Pika 1);
- (ii) dënim me gjashtëmbëdhjetë (16) vjet burgim për krimin e luftës të torturës (Pika 3); dhe
- (iii) dënim me tetëmbëdhjetë (18) vjet burgim për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pika 4).

Trupi Gjykses ju dënon me dënim të njësuar me tetëmbëdhjetë (18) vjet burgim, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

65. Z. Shala, mund të uleni.

Zyra Administrative do të shpërndajë tani versionin konfidencial të Aktgjykimit në formë elektronike.

66. Një kopje e legalizuar e versionit në gjuhën angleze do t'i jepet z. Shala sa më shpejt sot. Versioni në gjuhën shqipe do t'i jepet z. Shala pasi të jetë gati, dhe palët dhe Mbrojtësi i Viktimave ftohen të kontaktojnë Zyrën Administrative në lidhje me këtë aspekt, në qoftë se është e nevojshme. Trupi Gjykses do të nxjerrë një version të redaktuar publik të Aktgjykimit për publikun më pas.

67. Së fundi, Trupi Gjykses rikujton se ruan juridiksion në këtë çështje në lidhje me lëshimin më pas të Urdhrit për Zhdëmtim ku do të specifikohet kompensimi i përshtatshëm për viktimat ose në lidhje me ta, në pajtim me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

Seanca mbyllet.